




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË FONDIT PËR SIGURIME SHËNDETËSORE PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Fondit për Sigurime Shëndetësore, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

C1 FSSH kishte mbivlerësuar regjistrin e detyrimeve kontigjente për 545,200€, për shkak se kishte përfshirë katër lëndë të cilat duhej të trajtoheshin si obligime të papaguara dhe dy lëndë të cilat ishin të paguara dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Fondit për Sigurime Shëndetësore kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në 20 raste në vlerë 869,472€, FSSH kishte lëshuar fletëzotime bazuar në një profaturë të vetme duke anashkaluar kërkesën e UA për dy profatura;
- A2 Në shtatë (7) raste në vlerë prej 163,165€, kemi vërejtur që lëndët e kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm që nga viti 2019, nuk ishin paguar me kohë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit të Sigurimit Shëndetësor është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit të Sigurimit Shëndetësor është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi i Bordit Drejtues të Fondit të Sigurimit Shëndetësor është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Fondit për Sigurime Shëndetësore është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Fondit për Sigurime Shëndetësore me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Fondit për Sigurime Shëndetësore.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e pasurive, obligimeve të papaguara dhe detyrimeve kontigjente.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Mbivlerësim i regjistrit të detyrimeve kontigjente

Gjetja

Sipas nenit 3 të Rregullës financiare nr.02/2013 MF për raportimin e detyrimeve të papaguara, Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për regjistrimin e të gjitha faturave ose detyrimeve tjera në SIMFK në përputhje me Rregullat MFK-së brenda tri ditëve të punës pas pranimit të faturës ose ngritjes së detyrimit përkatës. Po ashtu, sipas nenit 18 të Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore "Organizatrat buxhetore në harmoni LMFPP raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente".

Në gjashtë (6) raste në vlerë 545,200€, FSSH kishte mbivlerësuar regjistrin e detyrimeve kontigjente duke i përfshirë lëndët të cilat i plotësonin kushtet që të trajtohen si obligime të papaguara dhe lëndët të cilat veç se ishin paguar dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi. Detajet e këtyre janë prezantuar në vijim:

- Në regjistrin e detyrimeve kontigjente me fletëzotime për rastet emergjente dhe rastet e rregullta, FSSH kishte paraqitur katër (4) raste/lëndë në vlerë prej 339,200€ të pacientëve që kishin përfunduar trajtimet shëndetësore dhe kishin sjellë raportet mjekësore e financiare. Një (1) nga këto lëndë ishte shqyrtuar dhe ishte aprovuar nga Bordi për TMJSHP, derisa tri (3) të tjera nuk ishin aprovuar ende edhe pse i plotësonin kushtet administrative dhe financiare për aprovim; dhe
- Në dy (2) raste në vlerë 206,000€, në regjistrin e detyrimeve kontigjente ishin përfshirë lëndë të cilat veçse ishin paguar dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme si rezultat i volumit të madh të pagesave dhe ngarkesës së madhe për pastrimin e regjistrave në fund vit me rastin e ndarjes së mjeteve shtesë nga qeveria.

Vlen të theksohet se krahasuar me vitin paraprak ku vlera e mbivlerësimit të detyrimeve kontigjente ishte 4,814,162€, këtë vit gjendja e këtij regjistri ishte përmirësuar dukshëm.

Ndikimi

Përfshirja e lëndëve që nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi dhe lëndëve që i takojnë detyrimeve financiare në regjistrin e detyrimeve kontigjente shkakton mbivlerësimin e këtij regjistri dhe nënvlerësimin e detyrimeve të papaguara.

Rekomandimi C1

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojnë se lëndët të cilat i kanë përmbushur kriteret për njohjen si detyrimeve të shqyrtohen në kohë sa më të shkurtër nga ana e Bordit për TMJISHP, të njëjtat të largohen nga regjistrat e detyrimeve kontigjente për t'u prezantuar në regjistrat e detyrimeve të papaguara. Po ashtu, të largohen nga regjistri i detyrimeve kontigjente lëndët të cilat janë paguar dhe nuk paraqesin asnjë lloj detyrimi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Lëshim i fletëzotimeve në mungesë të aplikacioneve të plota sa i përket profaturave

Gjetja Sipas UA 03/2017 për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike - Neni 4, aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dy pro-fatura nga dy institucione shëndetësore ku mund të ofrohet shërbimi shëndetësor. Profaturat kërkohen për rastet kur nuk ka çmime referente për diagnozat e përcaktuara në këtë udhëzim. Kjo rregull vlen për rastet e rregullta dhe ato emergjente.

FSSH në 20 raste në vlerë prej 869,472€, kishte lëshuar fletëzotime bazuar në një pro-faturë të vetme, për rastet të cilat nuk kishin çmime referente të diagnozave të përcaktuara në udhëzimin administrativ. Këto fletëzotime i takonin periudhës prej 2019 deri në qershor 2023.

FSSH, në shtator të vitit 2023 kishte aprovuar UA të ri nr 03/2023 për trajtime mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, duke ndryshuar/plotësuar këtë nen me kërkesën ku aplikacionit duhet ti bashkëngjiten tri profatura.

Kjo kishte ndodhur për shkak të urgjencës që kanë pasur këto raste si dhe kohës se kufizuar për kompletim të dokumentacionit prej 72 orësh (3 ditë).

Ndikimi Lëshimi i fletëzotimeve në mungesë të dy profaturave shkakton mos pajtueshmëri ligjore dhe mund të ndikojë në çmime më të mëdha të aprovuara për trajtime në mungesë të konkurrencës duke dëmtuar kështu buxhetin e organizatës. Për më shumë kjo mund të ndikoj edhe në vonesa apo mos aprovim për pagesë të atyre lëndëve nga Bordi.

Rekomandimi A1 Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë se fletëzotimet lëshohen vetëm atëherë kur lëndët janë të kompletuara dhe kanë përmbushur kriteret e UA-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mos kryerja e pagesave për fletëzotimet e lëshuara

Gjetja Sipas UA 03/2017 për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike - Neni 5 Procedurat për raste emergjente paragrafi 6 parasheh se ekzekutimi i pagesës mund të marr kohë deri në gjashtë muaj. Po ashtu sipas UA 03/2023 i TMJISHP, neni 5 paragrafi 1.5 dhe neni 6 paragrafi 6 parasheh se procedurat e pagesës duhet të përfundojnë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e dorëzimit në Divizionin e Financave, përjashtimisht në rastet kur nuk ka fonde në dispozicion.

Në shtatë (7) raste në vlerë prej 163,165€ kemi vërejtur që lëndët e kompletuara me dokumentacionin e nevojshëm që nga viti 2019, nuk ishin paguar ende.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos marrjes së masave të nevojshme për

trajtimin e mëtutjeshëm të këtyre lëndëve nga personat përgjegjës dhe në disa raste për shkak të paqartësive në lëndë.

Vlen të theksohet se me aprovimin e buxhetit shtesë prej 15,000,000€ nga qeveria, FSSH kishte paguar obligimet e rrjedha nga programi i TMJISHP duke e përmirësuar dukshëm gjendjen në këtë regjistër.

Ndikimi

Mos kryerja e pagesave kundrejt fletëzotimeve të lëshuara ndikon që Institucionet shëndetësore jopublike mund të hezitojnë në kryerjen e shërbimeve në të ardhmen bazuar vetëm në fletëzotime. Për më shumë, mund ta bëjë FSSH-në subjekt të padive, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi A2

Bordi Ekzekutiv dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm në mënyrë që obligimet të paguhen brenda afatit. Për rastet tek të cilat ka paqartësi, të ndërmerren hapat e nevojshëm për sqarimin e tyre në mënyrë që të pastrohen regjistrat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 77,357€, pasurive jokapitale është 6,626€, si dhe e stoqeve 92,631€.

Çështja A3 - Mbivlerësim i stoqeve

Gjetja

Neni 6.3 i rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, specifikon se 'Pasuria Kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Ne identifikua se, FSSH kishte bërë regjistrim të dyfishtë të pasurisë "Workstation AIO HP PC" në vlerë origjinale 2,249€ si dhe pasurisë "Switch 48 port CISCO" në vlerë origjinale 16,072€ duke i regjistruar të njëjtat në regjistrin e pasurisë mbi 1,000€ në SIMFK dhe në regjistrin e stoqeve duke shkaktuar mbivlerësim të stoqeve në vlerë prej 18,320€. Këto pasuri nuk ishin vënë në përdorim gjatë vitit 2023.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosnjohjes së rregullave përkatëse nga zyrtarët e pasurisë.

Ndikimi

Raportimi i dyfishtë i pasurisë ndikon në mbivlerësimin e pasurisë duke shkaktuar prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PFV.

Rekomandimi A3

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar se regjistrat e pasurive raportohen saktë dhe drejtë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Mos-harmonizimi i regjistrave të pasurisë me raportet e inventarizimit

Gjetja

Neni 19 i rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, specifikon se 'Raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Komisioni i inventarizimit kishte kryer inventarizimin e pasurisë mirëpo nuk e kishte bërë harmonizimin e raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurive para përgatitjes së PFV-ve.

Kjo situatë ishte shkaktuar si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.

Ndikimi

Mos harmonizimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive, mund të ndikojë në mos raportimin e saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive në PFV.

Rekomandimi C2 Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojnë se pas kryerjes së procesit të inventarizimit, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet krahasimi në mes të gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁸	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	8,938,806	23,921,198	22,711,153	6,128,439	10,145,805
Grante Qeveritare - Buxheti	8,938,806	23,921,198	22,711,153	6,128,439	10,145,805

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 14,982,392€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjes së mjeteve shtesë me vendim të Qeverisë si dhe me transfere të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për pagesën e detyrimeve të dala nga lëshimi i fletëzotimeve.

Në vitin 2023 FSSH ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar me një përmirësim prej 18% në krahasim me vitin 2022.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	8,938,806	23,921,198	22,711,153	6,128,439	10,145,805
Pagat dhe mëditjet	413,806	396,198	396,198	341,756	340,712
Mallrat dhe shërbimet	500,000	255,000	223,486	187,452	216,242
Komunalitë	25,000	25,000	16,298	16,880	18,989
Subvencionet dhe transferet	8,000,000	23,245,000	22,075,171	5,582,351	9,400,993
Investimet Kapitale	0	0	0	0	168,870

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin ishte zvogëluar për 17,608€. Realizimi në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 245,000€. Kjo ulje ishte me kërkesë të FSSH-së për transferin e këtyre mjeteve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Realizimi i kësaj kategorie ishte 88% e buxhetit final;
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar nuk kishte pësuar ndryshime. Realizimi në këtë kategori ishte 65%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 15,245,000€. Kjo rritje ishte rezultat i transferit të mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 245,000€ si dhe të ndarjeve të mjeteve shtesë me vendime të qeverisë në vlerë prej 15,000,000€ për pagesën e detyrimeve të dala nga lëshimi i fletëzotimeve. Realizimi i subvencioneve ishte 95 % e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Pranimet e realizuara në vitin 2023 nga FSSH në vlerë 57,171€ ishin nga mjetet e kthyera në buxhetin e Republikës së Kosovës si rezultat i barazimeve të ndodhura me spitalet private për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore në lidhje me pagesat paraprake të pa shpenzuara.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	96,262	96,262	57,171	128,723	57,201
Të hyrat jo tatimore	96,262	96,262	57,171	128,723	57,201

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të FSSH ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime. FSSH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, katër (4) rekomandime ishin zbatuar, një (1) rekomandim nuk është i aplikueshëm më për faktin se është i fuzionuar dhe dy (2) rekomandime ishin zbatuar pjesërisht.

Vlen të theksohet se FSSH kishte ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të përmirësimit të theksuar të gjendjes krahasuar me vitin e kaluar sa i përket pagesës së detyrimeve të dala nga lëshimi i fletëzotimeve.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve)

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojë një rishikim detaj të regjistrit të detyrimeve kontigjente dhe një krahasim me të gjitha vendimet e Bordit për t'i larguar nga ky regjistër lëndët të cilat veç se janë paguar dhe ato për të cilat ekzistojnë detyrimet financiare, në mënyrë që vlera e këtij regjistri e raportuar në PFV të jetë e saktë dhe e drejtë. Po ashtu nevojitet bashkërendim me MSH-në për t'i identifikuar të gjitha lëndët që i takojnë FSSH-së, me qëllim të sigurimit të plotësisë, saktësisë së informatave financiare dhe raportimit të drejtë të tyre në PFV.	Ky rekomandim është i fuzionuar në rekomandimin e çështjes Mbivlerësim i regjistrit të detyrimeve kontigjente.	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të sigurojë se është bërë një analizë e regjistrat të detyrimeve kontigjente për t'u identifikuar të gjitha lëndët për të cilat janë përmbushur kriteret për njohjen e detyrimeve. Të njëjtat të shqyrtohen në kohë sa më të shkurtër nga ana e Bordit për TMJISHP dhe të evidentohen në regjistrat e detyrimeve të papaguara, në mënyrë që të mundësohet raportim i drejtë i tyre në PFV .	Edhe gjatë vitit 2023 regjistri i detyrimeve kontigjente përfshin lëndë të cilat veç se janë paguar dhe lëndë të cilat i përkasin detyrimeve financiare, mirëpo në krahasim me vitin paraprak dukshëm kemi përmirësim të gjendjes.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollat e brendshme, për të siguruar se pagesat janë në përputhje me procedurat dhe të parandalojnë rreziqet për vonesa apo detyrime të pa paguara.	Gjatë vitit 2023 pagesat janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet sigurojë vendosjen e një sistemi efektiv të kontrollit për të siguruar se të gjitha faturat e papaguara protokollohen dhe evidentohen.	Gjatë vitit 2023 faturat e pranuar ishin protokoluara	I zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të krijojë mekanizma efektiv për të siguruar se palët përfituese janë duke i respektuar detyrimet për arsyeshmërinë e plotë të shpenzimeve të subvencionuara.	Me hyrjen në fuqi të UA 03/2023 palët përfituese duhet fillimisht të i sjellin faturat, pastaj FSSH bënë subvencionimin.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit duhet të sigurojë se për pajisjet që nuk janë në përdorim duhet të analizohet mundësia për ta përdorur në organizatë, e nëse nuk i plotësojnë nevojat për përdorim të brendshëm, të gjinden alternativa tjera për trajtimin e këtyre pasurive.	Gjatë vitit 2023 FSSH kishte filluar të bënte ndërrimin e kompjuterëve sipas kërkesave të stafit.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Fondit, duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu duhet të sigurojë se harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurive, bëhet para përgatitjes së PFV-ve.	Gjatë vitit 2023 nuk ishte bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurisë, ndërsa sa i përket e-pasurisë ishte vënë në funksion.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Burbuqe Idrizi, Udhëheqëse e ekipit



Jehona Krasniqi, Anëtare e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
12-06-2024			
Brigada Org.	Shkllasf.	Nr. Prot.	Nr. Prot.
05	47	829	1
Clasif. Org.	Klasif. Kod	Str. Prot.	Nr. Stranica



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA			
REPUBLIC OF KOSOVO			
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE			
HEALTH INSURANCE FUND			
Nr. Org.	Nr. Prot.	Nr. Prot.	Nr. Prot.
Org. Unit.	1379	1379	1379
Nr. I fshesve	Date	Nr. I fshesve	Date
Stranica - 1-	12.06.24	Stranica	No. Pages
No. pages			
PRISHTINE - PRISHTINA - PRISTINA			

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravlja – Ministry of Health
 Fondi për Sigurime Shëndetësore – Fond Zdravstvenog Osiguranja – Health Insurance Fund
 Bordi Drejtues – Upravni Odbor – Steering Board

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Fondit për Sigurime Shëndetësore, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Bujar Kacuri

Drejtor i FSSH-së

Data: 12.06.2024, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁰, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Çështja C1 - Lëndët me numër protokoli 19-349 në vlerë 29,500€, lëndë me vendim 148-2021 në vlerë 130,000€, lënda 890-2023 në vlerë 160,000€, lënda 302/2023 e rregullt e shqyrtuar nga bordi në vlerë 19,700€, lëndë 1009-2023 e paguar në vlerë 156,000€ dhe lëndë me numër protokoli 23-586 e paguar në vlerë 50,000€.
- ⁶ Çështja A1 - Lëndët me numër protokoli 2603 në vlerë 7,420€, 22-865 në vlerë 9,814.70€ 20-428 në vlerë 26,950€, 20-124 në vlerë 29,400€, 21-1874 në vlerë 25,200€, 21-1820 në vlerë 30,000€, 19-2516 në vlerë 30,000€, 19-2688 në vlerë 30,000€, 21-1231 në vlerë 18,000€, 21-1186 në vlerë 15,200€, 21-856 në vlerë 19,703€, 21-81 në vlerë 28,700€, 21-1050 në vlerë 31,444€, 21-178 në vlerë 50,000€, 21-1470 në vlerë 70,000€, 20-756 në vlerë 160,000€, 21-962 në vlerë 113,240€, 21-351 në vlerë 134,000€, 2105 në vlerë 22,400€ dhe 22-848 në vlerë 18,000€.
- ⁷ Çështja A2 - Vendimet e marra për këto lëndë: Vendimi 1652/4 i datës 21/08/2019 në vlerë 30,000€, vendimi 1138/5 i datës 29/10/2019 në vlerë 30,000€, vendimi 611/2 i datës 15/06/2020 në vlerë 38,000€, vendimi 471/2 i datës 12/04/2022 në vlerë 30,000€, vendimi 541/2 i datës 27/05/2022 në vlerë 1,837.50€, vendimi 2888/2 i datës 13/01/2020 në vlerë 20,767€ si dhe vendimi 2896/4 i datës 23/11/2021 në vlerë 12,561€
- ⁸ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.